

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	12.01.2022	<p>Ju shkruajmë nga Zyra e Përmbartimit Privat "ASTREA" Shpk, lidhur me një procedurë përmbartimore që po ndjekim dhe pavarësisht shkresave të dërguara për pajisjen me informacion nga Zyra e Gjëndjes Civile Skrapar, nuk kemi pasur asnjë lloj reagimi zyrtar. Duke mos dashur të besojmë se kjo vonesë po bëhet në mënyrë të qëllimshme, kërkojmë të merrni në konsideratë këtë e-mail. Pasi nuk kemi mundësi tjetër se si të koordinojmë këtë bashkëveprim shkresor. Bashkëngjitur do të gjeni dhe njëherë dokumentacionin sa më sipër.</p>	12.01.2022	Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.2368 Prot. nr. 199-21 Regj. dt.19.10.2021 ju bëjmë me dije se shtetasja nuk ka ndërruar jetë (NID).Për të ndjerin po ju dërgojmë certifikatën e vdekjes.	E Plotë	Nuk Ka
2.	31.01.2022	<p>Në zbatim të VKM-së nr.431, datë 11/7/2018, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", VKM-së Nr.63, datë 27/01/2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" si dhe Urdhrit të MIE Nr.88, date 24/02/2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizime dhe infrastrukturës së Mbetjeve", Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Monitorimit pranë AKUM kërkon plotësimin e formularit (tabele) bashkëngjitur.</p> <p>Përfaqësuesit e Bashkive të plotësojnë atë pjesë të formularit ku sipas emërtimeve të projekteve janë Autoritet Kontraktor. Përfaqësuesit e Sh.UK të plotësojnë atë pjesë</p>	02.01.2022	Në përgjigje te emailit tuaj bashkëlidhur tabela me të dhënat e kërkuara për projektet e ujësjellësve të cilët janë duke u zbatuar në bashkinë Skrapar.	E Plotë	Nuk Ka

		të formularit ku sipas emërtimeve të projekteve janë. Autoritet Kontraktor gjithashtu dhe për projektet që janë përfitues ose presin të jenë përfitues të tyre. Ju lutemi plotësoni me korrektësi tabelën si dhe vendosjen e adresës dhe nr.cel të personit përgjegjës. Tabela e plotësuar do ti dërgohet me email nëpunësit të AKUM që ju ka dërguar këtë formular(tabelë).				
3.	12.01.2022	Në zbatim të ligjit 9780 date 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme" I ndryshuar me Ligjin Nr.107 datë 31/07/2014 "Për Planifikim dhe Zhvillimin e Territorit" VKM894 date 04.11.2015 "Për Unifikimin e Procedurave te kontrollit nga IKMT dhe ai I njësisë vendore" Kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse keni ndërtime të kundraligjshme në zonën që mbuloni. Të dërgohet informacion sipas nenit 5/të ligjit të mësipërm pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Drejtoria Rajonale Berat.	13.01.2022	Në përgjigje të shkresës suaj nr. 4 prot. datë 10.01.2022 protokolluar me nr.54 prot. datë 12.01.2022 me lëndë: "Kërkesë për informacion, ju informojmë se. Bashkia Skrapar gjatë periudhës kohore 07.10.2021 - 31.12.2021 nuk ka konstatuar raste të ndërtimeve pa leje.	E Plotë	Nuk Ka
4.	18.02.2022	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nëpërmjet Administratave të Zonave të Mbrojtura në qarqe në zbatim të ligjit 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", ka për qëllim ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës dhe biodiversitetit, nëpërmjet menaxhimit të zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresë nr. 402/8 prot., datë 30.07.2021, në pikën B "Masa organizative", Rekomandimi 2.1. "Njësitë e Qeverisjes Vendore si institucion ligj zbatues të krijojnë Data-Base	24.02.2022	Në përgjigje suajës me Nr.207 prot. datë 15.02.2022 , me lëndë: "Kërkesë për informacion dhe bashkëpunim", ju bëjmë me dije se Bashkia Skrapar nuk ka Data-basen(Shumëvjeçar) të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi, brenda territorit të saj dhe posaçërisht brenda zonave të mbrojtura. E Pavarësisht sa më sipër, ne së fundmi në bashkëpunim me administratën e zonave të mbrojtura, kemi	E Plotë	Nuk Ka

		<p>mbi ndërtimet informale në zonat e mbrojtura". Për këtë KLSH, rekomandon që AKZM/ADZM-të në qarqe të bashkëpunojnë nëpërmjet një komunikimi shkresor me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Institucionet ligj zbatuese dhe ASHK-në për të parandaluar ndërtimet në zonat e mbrojtura në shkallë vendi. Në përmbushje të këtij rekomandimi dhe në kuadër të bashkëpunimit me institucionet tuaj, lutemi na dërgoni Data-basen me ndërtimet informale që ju keni të identifikuar brenda territorit të bashkisë suaj, të cilat ndodhen dhe brenda kufirit të zonave me status "zonë e mbrojtur". Në këtë drejtim duke bashkëpunuar me strukturat tona, të monitorojnë gjendjen në terren dhe të përcaktojnë çdo ndërtim informal që ndodhet në zonë të mbrojtur, me qëllim evidentimin dhe marrjen e masave ligjore ndaj çdo ndërhyrje të paligjshme.</p>		<p>identifikuar disa objekte të ndërtuara në kohë të ndryshme, brenda zonave të mbrojtura që ndodhen brenda territorit të Bashkisë Skrapar, të cilat po ja u dërgojmë bashkëlidhur.</p>		
5.	25.03.2022	<p>Ne kuadër të procesit të zbatimit të Strategjinë Kombëtare të zhvillimit e Qëndrueshme Turizmit 2019-2023 (SKZHOT) dhe Planit të saj të Veprimit, miratuar me vendimin nr. 415, datë 19.06.2019 18 Këshillit të Ministrave, ka filluar procesi për hartimin e Raport Monitorimit të SKZHQT-se për vitin 2021 Në rolin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin Veprimit të SKZHQT-se, kërkohet dërgimi nga ana juaj i informacionit mbi statusin implementimit të aktiviteteve përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë, për vitin 2021. Për le teni. bashkëlidhur shkresës</p>	06.04.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, me nr. port 3028 dhe datë 24.3.2022, drejtuar Bashkisë Skrapar, në lidhje me procesin e përgatitjes së raportit të Progresit vjetor 2021, të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, ju informojmë mbi statusin e implementimit të aktiviteteve, të kryera nga bashkia Skrapar, si më poshtë: Në kuadër të implementimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-</p>	E Plotë	Nuk Ka

		<p>do të gjeni aktivitetet e parashikuara sipas planit të veprimit të strategjisë Sa më sipër, lutemi dërgimin e përgjigjes brenda 15 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese. në formë zyrtare dhe në adresat e postës elektronike të pikave të kontaktit te Drejtorisë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Turizmit pranë Drejtorisë së Përgjithshme Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit, përkatësisht në Aktivitetet nën objektivin specifik "Orientimi i investimeve publike drejt zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to": 1. Sinjalistikë e plotë rrugore dhe turistike në çdo destinacion turistik; 2. Hapësira parkimi dhe transport publik në çdo destinacion turistik; 3. Sistem informacioni turistik i përmirësuar në plazhe dhe zona turistike; 4. Furnizim pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë në destinacionet turistike. Aktivitetet nën objektivin specifik "Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi I produkteve të reja": 1. Ndërtimi i tre shtigjeve rajonale dhe dy shtigjeve kombëtare të çiklizmit. Aktivitetet nën objektivin specifik "Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi I produkteve të reja": 1. Botimi dhe promovimi i kalendarit vjetor të veprimtarive kulturore. Aktivitetet nën objektivin specifik "Zhvillimi i modelit të Menaxhimit të Destinacioneve": 1. Krijimi i Modelit të DMO-ve në zona pilot me potencial të lartë zhvillimi; 2. Identifikimi i mundësive për zhvillimin e veprimtarive të reja në destinacionet</p>		<p>2023(STZHQT)-së, Bashkia Skrapar, ka orientuar investimet publike drejt zonave me përparësi, për zhvillimin e turizmit dhe destinacioneve turistike, për përmirësimin e infrastrukturës bazë në to. 1-Në këtë kontekst Bashkia Skrapar, ka kryer investime ne infrastrukturën rrugore dhe turistike në të gjitha destinacionet turistike të saj. Rruga nacionale Berat-Skrapar, është e pajisur me Sinjalistikë rrugore dhe turistike, segmenti rrugor Çorovodë - Hambull, i cili është dhe atraksioni më i madh turisti natyror jo vetëm në Bashkinë Skrapar por dhe Qarkun Berat, është i pajisur me infrastrukturë të përshtatshëm rrugore dhe turistike dhe Bashkia nëpërmjet ndërmarrjes së shërbimeve siguron mirëmbajtjen e saj përgjatë gjithë sezonit turistik. Në destinacionin turistik Ujëvara e Bogovës, janë kryer investime ne infrastrukturën rrugorë dhe Sinjalistikë dhe rritja e vizibilitetit në këtë destinacion ka çuar në rritjen e ndjeshme të fluksit të turistëve. Parkut Kombëtar mali i Tomorrit aksesohet nga 2 drejtime, 2 akse te cilat janë plotësisht funksionale dhe të pajisur me infrastrukturë. Rruga e re e asfaltuar e malit te Tomorrit, ka patur impakt të madh,</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>ekzistuese; 3. Rritja e cilësisë dhe e llojeve të shërbimeve në destinacionet turistike.</p>		<p>në këtë destinacion te rëndësishëm, jo vetëm nga pikëpamja fetare si vend pelegrinazhi më i madh në vend. Por dhe nga pikëpamja turistike, si park kombëtar, që frekuentohet në çdo kohe te vitit. 2-Destinacionet turistike të Bashkisë Skrapar, ofrojnë hapësira parkimi për mjetet e turistëve. Shërbimi i transportit publik nuk mund të ofrohet, por ai mbulohet nga shërbimi privat, të cilët e ofrojnë me kosto të përballueshme. 3-Bashkia Skrapar ofron informacion në zyrën e turizmit në pikën infopoint ne qendër të qytetit, në bar restorantet lokale, në të cilat janë shpërndarë dhe broshurat informative për turistët që vizitojnë zonën. Krahas këtij informacioni bashkia ofron informacion për turistët në pikat kryesore të hyrjes së tyre si aeroporti i Tiranës dhe porti i Durrësit duke shpërndare broshura në hotelet dhe restorantet që ndodhen në këto zona, ku turistët marrin dhe kontaktet e para dhe informacionet mbi vendet e mundshme, që ata mund të vizitojnë. 4.Furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë të pijshëm i destinaconeve turistike. Të gjitha destinacionet turistike të bashkisë Skrapar, janë furnizuar në mënyrë të</p>		
--	--	---	--	---	--	--

			<p>pandërprerë, me energji elektrike. Përsa i përket me ujë të pijshëm, destinacionet turistike, furnizohen normalisht me ujë të pijshëm. Projekti i ujësjellësit të qytetit, do ti japë një zgjidhje të qëndrueshme furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm, qytetit të Çorovodës dhe zonave përreth tij. Zhvillimi i Programit të Turizmit Natyror dhe krijimi i produkteve të reja, Bashkia Skrapar, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë, kësaj forme turizmi dhe produkteve që ajo krijon. Në fushën e turizmit natyror, Bashkia Skrapar, ka destinacione turistike me impakt lokal, rajonal dhe kombëtar. Kanionet e Osumit, Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit, Ujëvara e Bogovës, Shpella e Pirogoshit dhe dhjetëra monumente të tjera natyrore, janë në fokus të punës së bashkisë për zhvillimin e turizmit natyror, dhe krijimit të produkteve të tija. Nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë lokale, rajonale, kombëtare dhe të huaj, bashkia Skrapar ka krijuar disa disa produkte turistike të turizmit natyrorë, që ndikojnë dhe do të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të zonës nëpërmjet turizmit.1-Produkti kryesor që turizmi natyror krijon mbetet rafting dhe kayaking në kanionet e Osumit.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Për të lehtësuar këtë aktivitet Bashkia Skrapar ka investuar në pikat e hyrjes dhe daljes nga lumi duke ndërtuar struktura të përshtatshme për këtë kategori turistike, si dhe mirëmbajtjen e tyre, përgjatë gjithë vitit dhe në mënyrë të veçantë, përgjatë kohës së sezonit të raftingut, që përkon me muajit Mars-Qershor i çdo viti. Do të doja të përmendja faktin, që lumi Osum shfrytëzohet nga shumë operatorë turistike që bëjnë rafting dhe këtë operatorë nuk paguajnë asgjë për bashkinë Skrapar, për shërbimin e mirëmbajtjes. Bashkia vetë hartoi një rregullore për menaxhimin e shërbimit të raftingut, duke vendosur një taksë minimale, për këta operatorë që kryejnë këtë aktivitet. Kjo taksë u kontestua, kaloi në gjykatë dhe ende është një çështje e pazgjidhur. Për ti dhënë një zgjidhje të qëndrueshme, sipas praktikave rajonale dhe botërore, do të donim dhe bashkëpunimin e ministrisë, me qëllim që ky shërbim që bashkia kryen, kostoja e tij të mos rëndojë buxhetin e bashkisë, por të paguhet nga këta operatorë turistikë, që kryejnë aktivitete fitimprurëse. 2.Një produkt tjetër turistikë i aktiviteteve në natyrë, në bashkinë Skrapar është dhe shëtitja me biçikleta malore. Bashkia për këtë</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>aktivitet ka përcaktuar dy akse ,me një nivel vështirësie mesatare , që mund të realizohen përgjatë gjithë vitit. 1-Aksi Çorovode-Kanioni i Gradecit - Gjërbes me gjatësi 27 km 2.Aksi Çorovode-Bogovë me gjatësi 17 km. Gjithë informacioni turistik mbi këto akse ndodhet i pasqyruar ne faqen web visit Skrapar dhe mund të aksesohet nga çdo turist qe disponon GPS në telefonin e vet. 3.Treking Për këtë aktivitet turistik natyror bashkia Skrapar, ka përcaktuar 2 akse, të cilat paraqesin një nivel vështirësie të lehtë dhe të mesëm, dhe që mund të realizohen përgjatë gjithë vitit. 1.Treking përgjatë kanioneve të lumit Osum më gjatësi 12 km 2.Treking përgjatë kanionit të Gradecit me gjatësi 8km 3. Treking në malin e Tomorrit me gjatësi 2 km 4.Alpinizëm Muret shkëmborë të kanionitit të Gradecit me lartësi 300 m janë të përshtatshëm si për mure ngjitëse ashtu dhe "palestra " nga turistet. Përsa i përket aktivitetit turistik "Zhvillimi i Programit të Turizmit Tematik dhe krijimi I produkteve të reja” Bashkia Skrapar, pavarësisht vështirësive që krijoi pandemia botërore e Covid-19, i ka dhënë vëmendjen e duhur. Bashkia ka hartuar kalendarin vjetor te festave dhe veprimtarive kulturore. Ky</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>kalendar është inkorporuar dhe në kalendarin rajonal të festive të qarkut Berat. Krahas botimit një vëmendje e veçante i kushtohet dhe promovimit të tij. Bashkia Skrapar dispono një website visit Skrapar dhe ky site ofron gjithë informacionin e nevojshëm, mbi aktivitetet dhe vendet që ai mund të vizitojë. Zhvillimi i modelit të Menaxhimit të Destinacioneve Bashkia Skrapar, ka identifikuar mundësitë për zhvillimin e veprimtarive të reja në destinacionet ekzistuese dhe po bashkëpunon me grupet e interesit, për ti jetësuar këto veprimtari. Si veprimtari të reja, në destinacionet ekzistuese mund të përmendim sistemin e Guest House apo Agro Turizmi dhe krijimin e aktiviteteve që lidhen me to. Në Parkun Kombëtar të malit të Tomorrit ky system ka evoluar më shumë se në destinacionet e tjera, e lidhur kjo dhe me infrastrukturën moderne, asfaltimin e rrugës së Tomorrit. Janë disa Guest House në këtë destinacion të cilat zhvillojnë në mënyrë të suksesshme aktivitetin e tyre, në këtë destinacion, pothuajse ne çdo kohë të vitit. Në destinacion tjetër shumë të rëndësishëm në kanionet e Osumit, po realizohen disa investime të tipologjisë Guest House, në fshatin Zabërzan dhe</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>Rovicë, dhe sigurisht shumë shpejt, do të ndiqen dhe nga investime të tjera. Në Bogovë janë kryer investime të rëndësishme në këtë fushë, duke ndërtuar Guest Houses. Projektet Ipard, që mundësojnë financimin e këtyre strukturave, po zgjojnë gjithnjë e më shumë interesin e fermerëve, që kërkojnë të aplikojnë për përthithjen e këtyre fondeve, për të përshtatur shtëpitë e tyre në Guest House, si mundësi reale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës nëpërmjet turizmit. Përsa i përket cilësisë së shërbimeve dhe llojeve të shërbimeve turistike që ofrohen në këto destinacione, pavarisht punës që bën bashkia, sektori i turizmit, për promovimin e zonës, produkteve tipike, ky shërbim është ende larg qasjes, që ky shërbim kërkon sot. Për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve turistike, bashkia ka aplikuar dhe zgjidhje alternative, duke përgjatë sezonit të verës kur është dhe fluksi më i madh, duke bashkëpunuar me shkollën e mesme të qytetit, duke ofruar punësim për nxënësit që flasin anglisht si guida lokale apo punësim në biznese. Bashkia ka identifikuar zonat që kanë potenciale të larta zhvillimi për të krijuar dhe sistemin e DMO-ve në zonat pilot. Si zona me potenciale</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>të larta zhvillimi në bashkinë Skrapar janë identifikuar: 1- Kanionet e Lumit Osum 2.Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit 3.Bogova Për këto zona me potenciale të larta zhvillimi nëpërmjet turizmit, bashkia ka hartuar dhe projekte zhvillimore, të cilat janë në pritje për tu implementuar, më qëllim që ato të mund të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet turizmi.</p>		
--	--	--	--	---	--	--